



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. _____ prot.

Belsh më: 27.03 .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-SHERBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *“Hartim Projekti “Rrjeti i funizimit per ujitjen e zones se Dumresë”.*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): PROJEKTE - 22114311-5

Vlera e fondit limit: 14 165 639.22 (katërmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nënëte pike njezet e dy) leke pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Belsh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. ARGUMENTIMI I FONDIT LIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE :

Në zbatim të urdhrimit të grupit “Për përlogaritjen e fondit limit, specifikimeve dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit” Nr .109 prot date 14.01.2026 ,të titullarit të autoritetit kontraktor, për objektin e mësipërm, të planifikuar për t`u kryer në programet e investimeve.

Perlogaritja e fondit limit referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, komisioni është mbështetur ne VKM nr.354 date 11.05.2016.

-Kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar nga Komisioni i ngritur me urdher të titullarit Nr .488 , 1dt. 13/11/2025 me Nr.3987 protokolli, referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme përmbajne administrimin e dokumentacionit, ligjor dhe administrative, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, nëpërputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

b.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, tëLigjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dheKreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-sëNr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet

.. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: *Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2,nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksavevendere” indryshuar, neni 5, pika c.neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2025 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshmenërealizimin e të paktën:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 40 %** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohet kontrata, vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë te deklaruara ne organet tatimore,

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçences profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, date 28.12.2016, e vlefshme për kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim lëshuar nga MIE dhe/ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, për këto kategori:

KAT 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a)- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

KAT 4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

KAT 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b)- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

d)- Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) – damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.

e)- Vepra të trajtimit të ujit. Kjo kategori jepet vetëm për personat juridikë (shoqëri/studio).

f)- Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

KAT. 8. PROJEKTUES GJEODET

a) – Rilevime inxhinierike.

c) – Sistemet GIS.

d) – Bazamente gjeodezike

KAT. 9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK – HIDROLOGJIK

d)– Studime e projekte hidrogeologjike.

Inxhinier Mjedisi

Çertifikuar/Licencuar si specialist për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Duke u bazuar në: VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, “Për miratimin e listës së profesioneve, kriterëve dhe procedurave për pajisjen me certifikatë profesionale dhe licencë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”; Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020;

Objekti i prokurimit konsiston në hartimin e një projekti për rrjetin e furnizimit me ujë për ujitje në zonën e Dumresë, i cili përbën një sistem kompleks inxhinierik që përfshin vepra hidraulike, rrjete shpërndarëse, struktura ndihmëse, matje topografike dhe analiza hidrologjike dhe gjeologjike. Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë licencat përkatëse për të gjitha disiplinat e përfshira në projektim.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
3 – a	Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate	Projekti përfshin ndërtimin e objekteve ndihmëse të sistemit të ujitjes si: godina teknike, dhoma pompash, struktura kontrolli dhe depozita të vogla. Këto objekte kërkojnë projektim konstruktiv për të garantuar qëndrueshmëri strukturore, rezistencë ndaj ngarkesave dhe siguri në shfrytëzim. Për këtë arsye kërkohet licencë për projektim konstruktor për realizimin e saktë të këtyre elementëve.
4 – c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale	Projekti i ujitjes mund të përfshijë stacione pompimi, sisteme automatizimi dhe kontrolli, si dhe furnizim me energji elektrike për funksionimin e rrjetit. Për këtë arsye kërkohet projektim i rrjeteve elektrike për të garantuar funksionim të sigurt dhe efikas të sistemit të ujitjes, në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë.
5 – b	Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi	Projekti konsiston në hartimin e rrjetit të furnizimit me ujë për ujitje, duke përfshirë tubacionet kryesore dhe dytësore, kolektorët dhe sistemet e shpërndarjes së ujit. Kjo kategori është thelbësore për dimensionimin hidraulik dhe funksionimin korrekt të rrjetit.

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
5 – d	Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse	Projekti përfshin projektimin e sistemit të ujitjes (vaditjes), përfshirë kanalet, tubacionet shpërndarëse dhe elementët e kontrollit të rrjedhës. Gjithashtu mund të përfshijë elementë kullimi për menaxhimin e ujërave të tepërta. Kjo kategori është drejtpërdrejt e lidhur me objektin kryesor të kontratës.
5 – e	Vepra të trajtimit të ujit	Në rastet kur kërkohet përmirësimi i cilësisë së ujit për përdorim në ujitje, projekti mund të përfshijë elementë trajtimi (filtrim, sedimentim, etj.). Kjo kërkon ekspertizë specifike për projektimin e këtyre veprave.
5 – f	Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkime, vepra nga rezervuarë/lumenj/puse	Zona e Dumresë karakterizohet nga prania e rezervuarëve dhe burimeve ujore, ndaj projekti përfshin vepra të marrjes së ujit, shkarkues, struktura kontrolli dhe elementë hidroteknikë. Këto kërkojnë projektim të specializuar për të garantuar funksionalitet dhe siguri hidraulike.
8 – a	Rilevime inxhinierike	Projekti kërkon matje topografike të detajuara të terrenit ku do të shtrihet rrjeti ujitës, përcaktimin e kuotave dhe pjerrësive. Pa këto të dhëna nuk mund të realizohet projektimi hidraulik dhe ndërtimi i rrjetit.
8 – c	Sistemet GIS	Projekti kërkon ndërtimin e një sistemi GIS për menaxhimin e rrjetit të ujitjes, hartimin e hartave tematike dhe administrimin e të dhënave gjeohapësinore, të cilat janë thelbësore për planifikimin dhe menaxhimin afatgjatë të sistemit.
8 – d	Bazamente gjeodezike	Për të garantuar saktësinë e projektimit dhe zbatimit, kërkohet ndërtimi i rrjeteve referuese gjeodezike dhe koordinatave, që shërbejnë si bazë për çdo matje dhe projektim në terren.
9 – d	Studime e projekte hidrogjeologjike	Projekti kërkon analizën e burimeve ujore (rezervuarë, ujëra nëntokësore), përcaktimin e prurjeve dhe vlerësimin e disponueshmërisë së ujit për ujitje. Në zonën e Dumresë këto studime janë thelbësore për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të kete te punësuar mesatarisht të paktën **6 (gjashte) punonjës** për periudhen **Janar 2026 – Mars 2026**.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**
...

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kerkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të References. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje gjashtë muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kerkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik të përfshirë në Licensën e Shoqërisë stafin si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, licence profesionale individuale dhe të jenë të përfshirë në Listë pagesën e Kontributeve të Sigurimeve Shogorore dhe Shendetesore dhe TAP, si më poshtë :

- ✓ -1 (një) inxhinier hidroteknik,
- ✓ -1 (një) inxhinier mjedisi,
- ✓ -1 (një) inxhinier gjeodet,
- ✓ -1 (një) inxhinier gjeolog
- ✓ -1 (një) inxhinier konstruktiv;
- ✓ -1 (një) inxhinier elektrik/mekanik;

a) Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të projektimit, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Janar 2026 –mars 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**
...

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin

e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Bazuar ne **Ligjin nr. 107/2014**, i ndryshuar me **Ligjin nr. 119/2020**, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; **Ligji nr. 8402/1998**, i ndryshuar me **Ligjin nr. 120/2020**, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; **VKM nr. 408, datë 13.05.2015**, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”; **VKM nr. 943, datë 28.12.2016**, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit; **Ligji nr. 162/2020**, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë **kapacitet teknik dhe profesional të mjaftueshëm**.

Duke marrë në konsideratë natyrën e projektit, që përfshin punime hidraulike, matje topografike, analiza gjeologjike dhe hidrologjike, projektim strukturor dhe integrim të sistemeve elektrike/mekanike, prania e këtij stafi është e domosdoshme për garantimin e cilësisë, saktësisë teknike dhe realizimit me sukses të projektit.

Kjo kërkesë është në përpjesëtim të plotë me objektin e prokurimit dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës, por një garanci për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë.

STAFI I KËRKUAR	PËRSHKRIMI I ROLIT	ARGUMENTIMI
Inxhinier Hidroteknik	Projektim dhe dimensionim i veprave hidraulike dhe rrjeteve të ujitjes	Projekti konsiston në hartimin e një sistemi furnizimi me ujë për ujitje, i cili përfshin dimensionimin hidraulik të rrjetit të tubacioneve, projektimin e veprave të marrjes së ujit, strukturave të kontrollit dhe shpërndarjes. Inxhinieri hidroteknik është thelbësor për analizën e prurjeve, presioneve, humbjeve hidraulike dhe optimizimin e sistemit, duke garantuar funksionim efikas dhe të qëndrueshëm të rrjetit të ujitjes.
Inxhinier Mjedis	Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore	Projekti zhvillohet në një zonë me burime natyrore dhe ekosisteme të ndjeshme, ndaj kërkohet vlerësimi i ndikimeve mjedisore të ndërhyrjeve të propozuara. Inxhinieri i mjedisit siguron që projekti të jetë në përputhje me legjislacionin mjedisor, të minimizojë ndikimet negative dhe të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe tokësore.
Inxhinier Gjeodet	Matje topografike, rievime dhe përpunim i të dhënave gjeohapësinore	Projekti kërkon matje të sakta topografike për përcaktimin e kuotave, pjerrësive dhe trasimit të rrjetit të ujitjes. Inxhinieri gjeodet realizon rievimet në terren, përpunon të dhënat dhe harton bazën gjeodezike dhe hartografike, e cila është thelbësore për projektimin hidraulik dhe zbatimin korrekt të projektit.
Inxhinier Gjeolog	Studimi i kushteve gjeologjike dhe hidro-gjeologjike të terrenit	Zona e projektit karakterizohet nga kushte të veçanta gjeologjike dhe prani e ujërave nëntokësore. Inxhinieri gjeolog analizon përbërjen e tokës, qëndrueshmërinë e terrenit dhe ndikimin e ujërave nëntokësore në projekt, duke garantuar që rrjeti i ujitjes dhe veprat shoqëruese të projektohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.
Inxhinier Konstruktiv	Projektim strukturor i objekteve dhe veprave mbështetëse	Projekti përfshin ndërtimin e strukturave si dhoma pompash, priza, bazamente dhe elementë të tjerë prej betoni arme. Inxhinieri konstruktiv siguron dimensionimin dhe projektimin e këtyre strukturave në përputhje me normat teknike, duke garantuar qëndrueshmëri, siguri dhe jetëgjatësi të veprave.

STAFI I KËRKUAR	PËRSHKRIMI I ROLIT	ARGUMENTIMI
Inxhinier Elektrik/Mekanik	Projektim i sistemeve elektrike dhe mekanike për funksionimin e rrjetit	Sistemi i ujitjes mund të përfshijë stacione pompimi, pajisje mekanike dhe sisteme kontrolli/automatizimi. Inxhinieri elektrik/mekanik është i nevojshëm për projektimin e furnizimit me energji, dimensionimin e pompave dhe integrimin e sistemeve teknologjike, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe efikas të gjithë sistemit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS ose 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station;

- Për pajisjet e mesiperme , të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...”.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mesiperme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave..

Objekti i prokurimit përfshin hartimin e projektit të rrjetit të furnizimit me ujë për ujitje, i cili kërkon realizimin e matjeve të sakta topografike për përcaktimin e kuotave, pjerrësive dhe trasimit të rrjetit. Saktësia e këtyre matjeve është thelbësore për projektimin hidraulik dhe funksionimin korrekt të sistemit të ujitjes. Pajisjet gjeodezike si GPS ose Total Station mundësojnë mbledhjen e të dhënave të sakta në terren dhe janë të domosdoshme për hartimin e bazës topografike mbi të cilën zhvillohet projekti.

KOMISIONI I KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT:

NJËSIA E PROKURIMIT: